



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.1571/1 prot.

Tiranë më 12.06.2024

Lënda: Dhënie mendimi mbi Draft-Methodologjinë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 515 prot., datë 06.06.2024, administruar me tonën me nr. 1517 prot., datë 10.06.2024, përmes së cilës dërgohet për mendim “*Draft-Methodologjia e identifikimit të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit*”, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “*Zyra e Komisionerit*”).

Nga shqyrtimi i Draft-Methodologjisë, konstatojmë se ky dokument trajton identifikimin, klasifikimin dhe kategorizimin e shërbimeve digjitale në të gjithë fushat e ekonomisë, përmbajtja e saj është e një natyre teknike në të cilën përcaktohen hapat dhe pragjet për identifikimin dhe klasifikimin e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit.

Për rrjedhojë, vlerësojmë se dokumenti i sipërcituar nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me fushën e veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit në zbatim të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi